

Buzmat para manastireve të ndizen vetëm nga banorët e Cetinës



Mitropolia bregdetare malazeze dhe udhëheqja e manastirit të Cetinës i kanë lutur të gjithë besimtarët, të cilët nuk jetojnë në Cetinë që në ditën e buzmit dhe për Krishtlindje të rrinë në shtëpitë dhe qytetet e veta , është kumtuar nga Mitropolia bregdetare malazeze. Ata u kanë bërë ftesë të gjithë besimtarëve ortodoksë që dallimet reciproke ti lënë anash dhe siç theksohet , duke respektuar të gjitha masat e parapara shëndetësore dhe rendin kishtar të mos bjenë pre e informatave të rrejshme , “të cilat i plasojnë disa politikanë të pa përgjegjshëm, OJQ dhe individ të caktuar , me qëllim që gjatë festave të Krishtlindjes të shkaktohen trazira dhe urrejtje në Mal të Zi”. Nga kjo Mitropoli theksojnë se nuk ka vend për urrejtje, armiqësi dhe mosbesim.